

Informacione të rëndësishme për konferencën e 50-të Ndërkombëtare të Studiuesve të Baladave, 1-5 shtator 2022

Konferenca e 50-të Komisionit Ndërkombëtar të Baladave (KfV) do të mbahet në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe do të hapet në mjediset e saj.

Konferenca do të nisë në Tiranë, një qytet i rrethuar nga kodra nga lindja dhe me pamje nga Adriatiku në perëndim, për t'u zhvendosur më pas në Gjirokastrë, qytet ky i shpallur si Trashëgimi Botërorë e UNESCO-s. Qyteti i vjetër i Gjirokastrës është i stilit lindor, me një kala nga e cila vështrohet gjithë qyteti. Në këtë qytet ndodhen shtëpi të vjetra prej druri të ndërtuara përgjatë shpateve. Në ditët e konferencës do të shijohet edhe një Festival Folklorik vendës **Divani lunxhjet**.

Konferenca e 50-të e KfV-së është në njëfarë mënyre një kthim në atdhe sa i përket fushës së studimit, pasi **Shqipëria është mikpritëse e një tradite kaq të rëndësishme të këngës epike.**

Udhëtimi dhe akomodimi

Delegatët mund të udhëtojnë vajtje-ardhje: Tiranë-Janinë (Greqi), që është 90 km nga Gjirokastra. Gjithashtu, kush dëshiron mund të udhëtojë me avion në Korfuz, të marrë tragetin në Sarandë e më pas autobus/taxi për në Gjirokastrë. Organizatorët po kujdesen për të bërë rezervime grupi në hotelet pranë vendit ku do të zhvillohet konferenca, kundrejt një çmimi preferencial.

Më poshtë gjeni detaje lidhur me udhëtimin dhe akomodimin:

Çdo një orë ka autobus të linjës aeroport-Tiranë (qendër). Bileta kushton 2,5 euro (300 Lekë) Shërbimi taksi nga aeroporti në qendër të Tiranës nuk kushton më shumë 15 euro.

Hotelet rreth qendrës kanë çmime të ndryshme. Ka disa hotele që ndodhen afër Akademisë, të cilët nuk kushtojnë më shumë se 40-50 Euro, po gjenden akoma edhe më lirë. B&B mund të konsiderohet një mundësi e këndshme dhe me çmim të arsyeshëm në Tiranë.

Ne sugjerojmë të rezervoni në dy hotelet e mëposhtme, të cilat ndodhen pranë Akademisë së Shkencave. I bëni me dije që jeni pjesë e konferencës së KfV në Shqipëri, për të përftuar çmim preferencial:

Hotel Austria <https://www.booking.com/hotel/al/austria.en-gb.html>

Hotel Oxford <https://hoteloxford.al/en/>.

Nëse zgjidhni një hotel që është shumë afër Akademisë, nuk do jetë e nevojshme të përdoret transporti publik. Bileta e transportit publik kushton 30 cent (40 Lekë).

E njëjta gjë në Gjirokastrë: Sipas dëshirës, mund të jetë e mjaftueshme edhe një B&B

Ne sugjerojmë të rezervoni tek hotelet e mëposhtme (ku të përmendni faktin se jeni pjesë e konferencës së KfV në Shqipëri): **Hotel Fantasy**: <https://fantasyhotel.al/>.

Hotel Bineri: <http://hotel-bineri.gjirokaster.hotels-al.com/en/>

Transporti Tiranë-Gjirokastrë si dhe Gjirokastrë-Butrint, do bëhet me autobus.

- Tarifa e pjesëmarrjes në konferencë: 60 euro (cash)

Kjo shumë do të shpenzohet për kafe gjatë pushimit në ditët e konferencës, printimin e materialeve, të librit të abstrakteve si dhe të një vakti gjatë konferencës.

Akademia e Shkencave siguron:

- Transportin dhe vaktin gjatë ditës së ekskursionit
- Një vakt (pas ceremonisë së hapjes së konferencës)
- Transportin Tiranë-Gjirokastrë
- Transportin Gjirokastrë-Tiranë

Kalendari i Konferencës

1 shtator (E enjte)	Mbërritja në Tiranë Ceremonia e hapjes në Akademinë e Shkencave
2 shtator (e premte)	Paraqitja e kumtesave; pasdite nisja për Gjirokastrë (udhëtimi i siguar).
3 shtator (E shtunë)	Paraqitja e kumtesave (Gjirokastrë)
4 shtator (E dielë)	Ekskursion në Butrint (i siguar)
5 shtator (E hënë)	Paraqitja e kumtesave (Gjirokastrë) Mbyllja zyrtare e konferencës
6 shtator (e martë)	Udhëtimi nga Gjirokastra në Tiranë (i siguar)